

PREFEKTURA E QARKUT DURRES
 HYRJE DT. 370 / 08.07.19
 DALJE DT. 15.
 Adresat: F.
 Aditi: AA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
 DREJTORIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Tiranë, më 02.07.2019

Nr. 2823 / 5 Prot.

Lënda : Dërgim i Raportit Final të Auditimit

Drejtuar : Z. ROLAND NASTO
 PREFEKTI I QARKUT

Durrës

Uderuar Z. NASTO,

Bashkëlidhur dërgojmë Raportin Final të Auditimit, mbi auditimin e kombinuar në Institucionin e Prefektit të Qarkut Durrës, për periudhën nga 01.07.2017 deri më 31.03.2019, kryer në zbatim të planit vjetor të punës të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, miratuar nga Ministri i Brendshëm me shkresën nr. prot.501 datë 22.10.2018, "Për miratimin e planit vjetor të veprimtarisë së Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2019" dhe Autorizimit të Drejtuesit të. DAB, për përgatitjen e angazhimit të auditimit, prot. nr.2823, datë 04.04.2019.

Në Raportin Final të Auditimit, janë reflektuar reagimet e bëra në Projekt Raportin e Auditimit, kthyer me shkresën Tuaj prot. nr.370/4, datë 16.06.2019.

Në zbatim të pikës d, të nenit 12 "Përgjegjësitë e titullarëve të njësive publike" të ligjit nr.114/2015, datë 22.10.2015, "Për auditin e brendshëm në sektorin publik" dhe pikave: 4.1.12 "Raportet e auditimit dhe plotësimi i plan veprimit nga njësia e audituar", 4.1.13 "Procedurat e ndjekjes së rekomandimeve të auditimit", të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik të miratuar me Urdhrin nr.100, datë 25.10.2016 të Ministrisë të Financave, nga ana Juaj të hartohet dhe të miratohet Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të angazhimit të auditimit dhe të dërgohet zyrtarisht në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm, në Ministrinë e Brendshme, jo më vonë se 20 ditë kalendrike nga marrja e Raportit Final të Auditimit. Nëse nuk sillet Plani i Veprimit të rekomandimeve me persona e afate konkrete për zbatimin e tyre, në zbatim të pikës: 4.1.13.1 "Procedurat e ndjekjes së rekomandimeve të auditimit", të MAB, do të informojmë Ministrin mbi mospërbushjen e përgjegjësisë ligjore të menaxhimit të lartë të subjektit të audituar. Gjithashtu në zbatim të pikës 4.1.13.3 "Përgjegjësia e njësisë për të zbatuar rekomandimet e AB" të MAB, Drejtuesi i njësisë së audituar duhet të caktojë një punonjës me përvojë që të evidentojë të gjitha rekomandimet e lëna nga auditimi i brendshëm, të komunikojë, të monitorojë dhe të informojë vazhdimisht në DAB mbi zbatimin e rekomandimeve deri në zbatimin e plotë të tyre.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin,

DREJTOR I AUDITIMIT

Arjan SULAJ



V. PLAN VEPRIMI I REKOMANDIMEVE TË AUDITIT.

Në zbatim të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin Publik", të Urdhrit të Ministrit të Financave nr. 60, datë 25.10.2016 "Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik", pika 4.1.12, sipas gjetjeve rekomandojmë :

Gjetje: Nga auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna e të pazbatuara deri në auditimin e fundit (rekomandimi nr.1) rezultoi se nuk është zbatuar një rekomandim i pazbatuar dhe për dy rekomandime që kanë qënë në proces zbatimi, nuk janë zbatuar. Nga 18 rekomandime të lëna në auditimin e fundit, janë realizuar 10 rekomandime, janë në proces zbatimi 3 rekomandime dhe nuk janë zbatuar 5 rekomandime. Rekomandimet e lëna në përfundim të auditimeve të mëparshme, kanë synuar përmirësimin e kontrollit të brendshëm në sistemet dhe fushat që kanë rezultuar me gjetje. Këto rekomandime janë pranuar nga ana e Institucionit, si e tillë niveli aktual i zbatueshmërisë të këtyre rekomandimeve, nuk është i duhuri.

Rekomandim: Rekomandimet e pazbatuara nga auditimet e mëparshme (trajtuar në pikën e parë të materialit) të përfshihen në planin e veprimit të radhës duke përcaktuar afate dhe persona përgjegjës konkret për zbatimin e tyre dhe linjat e raportimit tek eprori për zbatimin e tyre dhe përmirësimin e sistemeve në vijim. Menaxhimi i lartë i organizatës të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme progresin e bërë për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme dhe të raportojë periodikisht në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm në MB.

Gjetje: Nga ana e KVVTP së Prefektit të Qarkut Durrës, për periudhën e përfshirë në auditim, nuk është realizuar asnjë kontroll i drejtpërdrejtë me nismën e vet, mbi veprimtarinë dhe veprimet e kryera nga ish komisionet e ndarjes së taxës, në zonat me përparësi turizimin. Nga 24 vendime të marra nga KVVTP Durrës, është kaluar afati tremujor. Në dosje ka vendim (miratim) të drejtorit të KV për shtyrje të afatit deri në një muaj, por përsëri nuk është zbatuar afati prej tre muajsh.

Rekomandim: KVVTP pranë Prefektit, nër mbikqyrjen e Prefektit, të planifikojë e të kryejë kontrolle në zonat me përparësi turizimin. Për vonesat nga që krijohen nga Institucionet e tjera, KVVTP të njoftojë Prefektin, i cili duhet të marrë masat përkatëse ndaj këtyre Institucioneve. KVVTP e Prefektit të Qarkut Durrës, të shqyrtojë të gjitha kërkesat e individëve apo enteve

shtetërore, në drejtim të zbatimit të afateve. Për kërkesat, të cilave ju ka kaluar afati i shqyrtimit, të merren masa të menjëhershme për kryerjen e hetimit administrativ.

Gjetje: Në fund të periudhës ushtrimore 2018 vlera prej 182,000 lekë që përfaqëson gjendjen e pullave të zyrave të gjendjes civile është pasqyruar gabimisht në llogarinë 468 “*Debitorë të ndryshëm*”.

Rekomandim: Nëpunësi zbatues të kryejë sistemimin e vlerës prej 182,000 lekë që përfaqëson gjendjen e pullave të zyrave të gjendjes civile (letrave me vlerë).

Gjetje: Institucioni ka në inventar 2 objekte ndërtimore në vlerën fillestare 61,558,424 lekë, ku Godina Nënprefektit Krujë deri në momentin e përfundimit të auditimit nuk është regjistruar në ZVRPP dhe si rrjedhojë nuk është bërë vlerësimi i ndërtesës. Kjo godinë pasqyrohet në bilanc me vlerën e rikonstruksionit 3,505,044 lekë. Nga ana institucionit janë dërguar disa shkresa drejtuar MB për regjistrimin e sip faktike dhe nuk ka asnjë përgjigje.

Rekomandim: Menaxhimi i lartë i organizatës në bashkëpunim me drejtorinë e prefekturave në MB të marra masa për regjistrimin e godinës së N/prefekturës Krujë në ZRPP dhe të kryej vlerësimin e sipërfaqes së saj.

Gjetje: Sa i përket konsumit të karburantit rezulton se, për automjetin me targë AA564HC bërë hyrje me nr.06, datë 20.07.2018 nga ana e institucionit është përlllogaritur konsumi i karburantit me 11 litra/100 km, bazuar në proces verbalin e mbajtur më datë 31.07.2018 nga komisioni testimi i ngritur me urdhrin e titullarit nr.69/1, datë 31.07.2018, ndërkohë që ky mjet është i ri dhe përlllogaritja e karburantit duhet të bëhet sipas normës 7.1 litra x40% për 100 km të përcaktuar në certifikatën e automjetit (9.9 litra). Ky mjet për periudhën Korrik deri 31.12.2018 është furnizuar me 1798 litra karburant i cili është justifikuar me km e përshkruara dhe të pasqyruara në fletëudhëtime të cilat janë firmosur nga përdoruesi i mjetit, personat që kanë lëvizur sipas autorizimit dhe specialistja e financës dhe jo sipas leximit të tahometrit.

Rekomandim: Menaxhimi i lartë i institucionit të Prefektit të marrë masat e menjëhershme për të analizuar dhe nxjerrë përgjegjësinë për mos leximin e tahometrit të mjetit të ri me targë AA564HC dhe Institucioni në vijimësi të përlllogarisë konsumin e karburantit me normën që ka të përcaktuar automjeti në certifikatë 9.9 litra për 100km (7.1x40%).

Gjetje: Për vitin 2019 nuk kishte një marrëveshje bashkëpunimi lidhur me shërbimin për ruajtjen fizike. Institucioni kishte siguruar ruajtjen fizike të Institucionit nëpërmjet procedurës blerje e vogël deri më datën 10.04.2019. Nga kjo datë deri në fund të auditimit vazhdonte të mos kishte këtë shërbim gjë që sjell një ngërç dhe një rrisik për këtë Institucion. Nga auditimi i lidhjes dhe zbatimit të kontratës së lidhur me subjektin për ruajtjen fizike nuk ka dokument që vërteton kontrollin e shërbimit nga Institucioni i Prefektit, nuk është ngritur një komision për kontrollin e zbatimit të kontratës së shërbimit.

Rekomandim: Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës, i cili ka përgjegjësinë e administrimit të pjesës më të madhe të godinës (sipas VKM-së nr.1691 datë 10.10.2007), të marrë masa për sigurinë fizike të objektit për vitin 2019, të hartojë një draft marrëveshje me institucionet e tjera që kanë përgjegjësinë e administrimit duke përcaktuar të drejtat dhe detyrimet për secilin nga administratorët sipas të dhënave të VKM-së nr.1691 datë 10.10.2007 të ndryshuar, lidhur me sigurinë fizike të objektit. Në rast mosënie dakord nga administratorët për sigurinë fizike të objektit, të dërgohet menjëherë informacion pranë Drejtorisë së Policisë Vendore Durrës për

aplikimin e sanksioneve në zbatim të ligjit nr. 19/2016 "Për masat shitesë të sigurisë publike". Menaxhimi i Institucionit të Prefektit të kryejë kontrolle të herë pas hershmë mbi zbatueshmërinë e kontratës së shërbimit të ruajtjes fizike të Institucionit duke e dokumentuar atë.

Gjetje: Gjatë periudhës së auditimit ishin rekrutuar punonjës të cilët marrëdhënjet e tyre rregullohen me kod pune, pa procedura të shkruara dhe të dokumentuara lidhur me kriteret e përzgjedhjes (rekrutimit) të tyre për emërimet në pozicionet e punës vakante. Nga auditimi i bërë dokumentacionit për marrjen dhe dorëzimin e detyrës rezultoi se nuk disponohej ky dokumentacion për punonjësit e administratës së Prefektit Durrës.

Rekomandim: Institucioni i Prefektit, të marrë masat në vijimësi për hartimin e rregullave të shkruara për mënyrën e rekrutimit të punonjësve që nuk përfshihen në statusin e nëpunësit civil, duke përcaktuar qartësisht, kriteret dhe kualifikimin sipas pozicioneve të punës së vendeve vakante si dhe të bëjë lajmërimin për vende vakante. Institucioni të marrë masa që në përfundim dhe fillim të mardhënieve të punës së punonjësve të bëhet dorëzimi/marrja e detyrës duke e dokumentuar dhe administruar dokumentacionin përkatës.

Në zbatim të pikës d, të nenit 12 "Përgjegjësitë e titullarëve të njësive publike" të ligjit nr.114/2015, datë 22.10.2015, "Për auditin e brendshëm në sektorin publik" dhe pikave: 4.1.12 "Raportet e auditimit dhe plotësimi i plan veprimit nga njësia e audituar", 4.1.13 "Procedurat e ndjekjes së rekomandimeve të auditimit", të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik të miratuar me Urdhrin nr.100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave, nga ana Juaj të hartohet dhe të miratohet Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të angazhimit të auditimit dhe të dërgohet zyrtarisht në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm, në Ministrinë e Brendshme, jo më vonë se 20 ditë kalendarike nga marrja e Raportit Final të Auditimit. Nëse nuk sillet Plani i Veprimit të rekomandimeve me persona e afate konkrete për zbatimin e tyre, jemi të detyruar në zbatim të pikës: 4.1.13.1 "Procedurat e ndjekjes së rekomandimeve të auditimit", të MAB të informojmë Ministrin mbi mospërmbushjen e përgjegjësisë ligjore të menaxhimit të lartë të subjektit të audituar. Gjithashtu në zbatim të pikës 4.1.13.3 "Përgjegjësia e njësisë për të zbatuar rekomandimet e AB" të MAB, Drejtuesi i njësisë së audituar duhet të caktojë një punonjës me përvojë që të evidentojë të gjitha rekomandimet e lëna nga auditimi i brendshëm, të komunikojë, të monitorojë dhe të informojë vazhdimisht në MPB mbi zbatimin e rekomandimevederi në zbatimin e plotë të tyre.

GRUPI AUDITIMIT

Hamdi COBAJ

Natasha URUÇI

Elisa MJEKRA